

SHSKUK-ja pagoi dyfish më shtrenjtë për penjtë kirurgjikale



Faqe 2

Nxënësit dhe prindërit e konsiderojnë të panevojshëm Testin e Arritshmërisë



Faqe 2

Trumpi kërcënon Evropën me tarifa 100 për qind



Faqe 4

Shpërfytyrimi i "tapisë së Kosovës"

Faqe 7-14



# KOHA DITORE

e diel • 28 qershor 2026

Numri 10407

www.koha.net



KONSTITUIMI I KUVENDIT MUND TË NISË JAVËN E ARDHSHME, NËSE S'KA ANKESA DERI TË HËNËN NË MESDITË

## Shpallen rezultatet, sytë te formimi i institucioneve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shpallur rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të 7 qershorit. Institucionet do të mund të konstituohen nga java e ardhshme, nëse nuk do të ketë ankesa në rezultat deri mesditën e së hënës. E analistët presin që konstituimi i Kuvendit dhe formimi i institucioneve të mos shoqërohen me vonesa e bllokada, në kohën kur shteti përballet edhe me pasojat nga mungesa e vendimmarrjes

Donisa Fazliu

PRISHTINË, 27 QERSHOR - Konstituimi i institucioneve të reja do të mund të nisë nga java e ardhshme, nëse nuk do të ketë ankesa në rezultat përfundimtar, që të shtunën e shpalli Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Kryesuesi i këtij institucioni, Kreshnik Radoniqi, ka thënë se afati i ankesave përfundon në mesditën e së hënës.

"Pas këtij vendimi, kandidatët kanë të drejtë ankese ndaj shpalljes së rezultatit, në afat prej 48 orësh, duke filluar nga ora 12 sot, e që përfundon në orën 12 të hënës. Ankesat dorëzohen në Panelin për Ankese dhe Parashpresa", ka thënë Radoniqi në mbledhjen e së shtunës.

KQZ-ja e ka shpallur rezultat përfundimtar të zgjedhjeve të parakohshme të 7 qershorit, pasi paraprakisht Gjykata Supreme i ka hedhur poshtë ankesat e dy kandidatëve të Partisë Demokratike të Kosovës për deputetë, që kërkonin rinumërimin e votave të kandidatëve nga radhët e kësaj partie.

Radoniqi ka thënë se auditimi që u është bërë votave të numëruara nuk ka gjetur deformime në rezultate.

"Rinumërimi i 185 vendvotimeve, nuk ka nxjerrë ndonjë gjetje që do ta arsyetonte nevojën për rinumërim të tjera. Dallimet e evidentuara kanë qenë minimale dhe kryesisht lidhen me rikategorizimin e fletëvotimeve nga të pavlefshme në të vlefshme, si dhe me gabime njëzëzore gjatë numërimit fillestar", ka thënë ai.

Pro shpalljes së rezultatit përfundimtar kanë votuar të gjithë anëtarët e KQZ-së, prezentë në mbledhje.

Bazuar në të, shpërndarja e ulësve në Kuvend mbetet e njëjtë, sikur ajo e kalkuluar nga rezultati i numërimit edhe të votave të shtetasve që jetojnë jashtë Kosovës. Lëvizja Vetëvendosje ka fituar 47.13 për qind të votave, duke siguruar 53 ulëse në Kuvend, Partia Demokratike 19.44 për qind, përkatësisht 22 ulëse, Lidhja Demokratike 16.69 për qind, përkatësisht 18 ulëse, ndërsa Aleanca me 6.74 për qind, që ia kanë siguruar 7 ulëse në Kuvend. 20 ulëse të tjera janë ndarë mes partive të komuniteteve.

Po që se certifikimi ndodh të hënën, sfidë e menjëhershme për partitë politike është funksionalizimi i institucioneve të reja. Analistët kanë shprehur pritje që konstituimi i Kuvendit dhe formimi i institucioneve të mos shoqërohen me vonesa e bllokada, në kohën kur shteti përballet edhe me pasojat nga mungesa e vendimmarrjes.

Bazuar në Kushtetutë, seanca konstituive e Kuvendit duhet të mbahet më së largu 30 ditë pas shpalljes së rezultateve. Por, praktika e deritashme ka treguar se ajo thirret menjëherë pas certifikimit.

Analisti politik, Mazllum Baraliku ka thënë se pas konstituimit të Kuvendit, duhet të diskutohet çështja e zgjedhjes së presidentit.

vijon në faqen e dytë



Prishtinë, 27 qershor - Shtatë persona, përfshirë një fëmijë 5-vjeçar dhe pesë zjarrfikës, u lënduan nga zjarr i që përfshiu kulmin e një ndërtese afër Parkut të Qytetit në Prishtinë. Të lënduarit janë jashtë rrezikut për jetën, ndërsa shkaku i zjarrit ende nuk dihet. Zjarrfikësve u janë dashur orë të tëra për ta fikur zjarrin

VËRSHIMET E 2023-S

## Tre vjet pas përmbytjeve, ka qytetarë që nuk janë kompensuar për dëmin

Ardona Popova

SKENDERAJ, 27 QERSHOR - Vërshimet e 2023-s ia kanë shkatërruar biznesin Liridon Geci nga fshati Llaushë i Skenderajt. Ai ka thënë se nga përmbytja i ngordhën rreth 12 mijë pula, në fermat e të cilave pati investuar për 12 vjet.

"Dëmi është 470 mijë euro dhe ky është dëm në vija të trasha, pa hyrë në detaje të dëmeve të tjera që janë shkaktuar aty. Por ky është dëmi, biznesi ka falimentuar. Unë tash jam punësuar pas asaj në një vend pune edhe me rrogën që e marrë, gjysmën e rrogës e paguaj në përmbarim. Do të thotë kreditë që i kam pasur të biznesit mundohem t'i paguaj me rrogën që e marr", ka thënë Geci.

Geci ka thënë se edhe familjarë të tij ende paguajnë ratat e kredive, në të cilat hyjnë për ta ngritur fermën.

E, ndonëse dëmi nga vërshimet ndodhi tre vjet më parë, ai ka thënë se nuk është kompensuar.

"Krejt politikanët kanë qenë në vizitë përfshirë edhe kryeministrin Albin Kurti. Ai bile më patë premtuar personalisht dhe më ka thënë që ti s'ke me qenë vetëm këtu, ke me e pas mbështetjen tonë edhe shumë shpejt ke me e kthye në gjendjen që e ke pas, me mbështetjen tonë. Prej asaj ditë e deri më sot përveç atyre premtimeve të kota asnjë send, asnjë cent, as kurrëgjë", ka thënë Geci.

Vërshimet e 19 janarit të 2023-s patën shkaktuar dëme të mëdha në ekonomi familjare, biznese, kultura bujqësore dhe infrastrukturë rrugore në disa komuna, përfshirë Skenderaj, Mitrovicën e Jugut, Klinën, Istogun dhe Pejën, qytet ku nga përmbytja humbën jetën dy persona.

Në total, dëmet janë vlerësuar në rreth 34 milionë euro, por kompensimi i plotë i tyre ende nuk është realizuar. Drejtori i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Sazan Ibrahim, ka fajësuar qeverinë për mungesën e kompensimit. Ai ka thënë se vonesa ka edhe një impakt.

"Nëse kompensohen tash vlera e kompensimit dhe vlera e euros... në vitin 2023 ka pasur vlerë tjetër, e tash ka vlerë tjetër për shkak të inflacionit. Për këtë arsye, niveli qendror duke e parë që për shkak të kushteve klimatike po kemi vërshime më shpesh se sa që ka ndodhur viteve dhe dekadave të kaluara, duhet të adaptojë edhe legjislativonin në fuqi sa u përket fenomeneve natyrore", ka thënë Ibrahim.

KOHA ka dërguar pyetje në Qeveri lidhur me procesin e kompensimeve, por nuk ka marrë përgjigje.

© KOHA Ditore

"Çdo gjë është e mundur", Kepi i Gjelbër vazhdon ecurinë përrallore



Pamja e lojtarëve të Kepit të Gjelbër të mbledhur rreth një telefoni celular ndërsa shikonin sekondat e fundit të fitores së Spanjës ndaj Uruguait përpara se të shpërthenin në festime, ishte lloji i momentit që FIFA kishte shpresuar të shihte në Kupën e Botës së zgjeruar. Apo edhe gëzimi ...

Faqe 15